



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:188837

Datë: 10.10.2022

Numri i dokumentit: 03510157

P.nr.55/21

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, Gjyqtarit Burim Çaka, në çështjen penale ndaj të pandehurit I.Sh i akuzuar për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 3 lidhur me paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1686/2020 të datës 19.02.2021, më 10.10.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET marrëveshja me numër Nd.nr.62/22 e datës 03.10.2022 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimi e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurit I. (V...) Sh. dhe të dëmtuarës DBZHR- Pylltaria - Kaçanik.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1686/2020 të datës 19.02.2021, ndaj të pandehurit I.Sh për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 3 nën paragrafi 1 të KPRK-së, dhe pushon procedura penale, pasi që lënda është zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimi.

III. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj më datë 19.02.2021, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1686/2020, ndaj të pandehurit I. Sh për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321

paragrafi 3 lidhur me paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Gjykata me kërkesën e palëve e referoi lëndën në ndërmjetësim, si rrjedhojë e kësaj, Gjykata aprovoi marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 par 1 nën paragrafi.1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr.06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimit Nd.nr.62 /2022 e datës 03.10.2022.

Lidhur me shpenzimet procedurale u veprua konform dispozitës së nenit 453 të KPPK-së.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

P.nr.55/21 datë 10.10.2022

Gjyqtari:
Burim Çaka

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate